



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 42

Datë: 11. 12. 2022. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Njoftim lidhur me vendimin e Presidentes për shtyrjen dhe caktimin e datës së re të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunitat: Mitroivcë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakoheshme për Kuvendin Komunal në Zveçan dhe Leposaviq
3. Të ndryshme

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 42-të.

Në vazhdim, kryetari z. Radoniqi, paraqiti rendin e ditës, dhe pyeti nëse ka ndonjë vërejtje, propozim...

Burim Ahmetaj, krye shef i Sekretariatit tha se, ka një rekomandim nga Sekretariati për KQZ-në.

Ilir Gashi, lidhur me planin e punës, tha se është mirë që të jetë pjesë e agjendës së kësaj mbledhje, përgatitjet sepse, është me plan të punës !

Me 11 për, u miratua rendi i ditës.

1. **Burim Ahmetaj,** krye shef i SKQZ-së, tha se në pajtim me ligjin, me nenin 66.5, paragrafi F të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe bazuar në vendimin e Presidentes të datës 14.11.2022, me nr. protokollin 09/1358/2022 për shpalljen e zgjedhjeve për Kryetar Komunave dhe për asamblist të

Kuvendeve Komunale, KQZ ka filluar me organizimin e zgjedhjeve. Bazuar në këto vendime, KQZ ka miratuar buxhetin, planin operacional dhe planet e tjera, përfshirë edhe planet e tjera operationale dhe shumë aktivitete tjera. SKQZ, ka kryer përgatitjet, dhe teknikisht ka qenë gati. Mirëpo, lidhur me vendimin e Presidentes të datës 10.12.2022 për shtyrjen dhe caktimin e datës së re të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakoheshme për Kuvendin Komunal në Zveçan dhe Leposaviq, rekomandon KQZ për pezullimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka...?

Ibrahim Selmanaj: Në bazë të shkresës së Presidentes dhe vendimeve të tjera, po kuptoj se pezullimi bëhet deri në afatin tjetër, të paraparë...

Ilir Gashi: Ne, realisht e kemi një datë të deklaruar, por që është shtyrë për shkak se nuk pati kushte. Pra, ne jemi në proces, dhe data e re kërkon një riorganizimi, plan të ri operacional...

Duhet të kemi parasysh sanksionimet eventuale, obligimet në proces, prandaj mendoj se jemi në proces, vetëm se duhet të riorganizohemi më tutje...

KOZ, duhet të mbidhet, dhe tu përshtatet datave të reja...

Sami Hamiti: Ajo që dashta të them, edhe u tha, por ne s'kemi nevojë të ngutemi por, të bëjmë një plan operacional që, të jemi të kujdesshëm dhe ne të bëjmë punën tonë...

Alim Rama: Meqë, rrethanat nuk janë dhe vendimi i Presidentes është për shtyrje, tash Sekretariati e vlerëson gjendjen, mirëpo një plan i ri operacional mund të bëhet, ka kohë...Ne si KQZ, është e rëndësishme ta kryejmë punën tonë...

Ilir Gashi: Ne, kemi hy në disa obligime. Ne, duhet ti kryejmë obligimet tona, ndonjë kontratë etj. Në mbledhjen e radhës, është mirë ta kemi një pasqyrë të shpenzimeve deri më sot, karshi këtij procesi...

Në këtë pikë, diskutuan: **Burim Ahmetaj** i cili tha se, pezullimi është bërë mirëpo, ne kemi një proces të ri përpara...Kemi hyrë në procedura kontraktuale, mirëpo ne do ti shtyjme ato afate që mundemi...

Ilir Gashi, tha se duhet tash të kërkojmë buxhet, sepse tremujori i vitit të ri, paraqet problem në realizimin e objektivave...

Arianit Elshani, tha se garantimi i sigurisë, duhet të bëhet në relacion me normalizimin e gjendjes. Këtë vendim, ne e mirëpresim, ndërsa planin ne duhet ta rishikojmë dhe ta harmonizojmë çdo gjë, me datën e ardhshme të caktuar të zgjedhjeve atje...

Kurse, **Sami Hamiti,** tha se me plan pune, kemi mbajtjen e një punëtorie. Të shikohen mundësitë se, a mund ta organizojmë...Afatet janë të shkurtër, dhe kjo duhet të bëhet shpejt në këtë vit fiskal...

Ndërsa, **Burim Ahmetaj,** tha se në kuadër të planit të punës, po, kemi paraparë një punëtori, dhe kemi bërë disa përgatitje...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka tjetër, shihemi në takimin e ardhshëm...

